

VENDIM
Nr.7, datë 21.3.2006

PËR MJAFTUESHMËRINË E PROVIGJONEVE TEKNIKE E MATEMATIKE TË
SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Në mbështetje të shkronjave “i” dhe “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, nenit 101 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, rregullores nr.2, datë 22.12.2004 “Mbi bazat, metodat dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jojetës” edhe rregullores nr.8, datë 22.12.2004 “Mbi bazat, metodat dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike” të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë të mjaftueshme provigjionet teknike e matematike të datës 31.12.2005 të përlllogaritura nga shoqëritë INSIG sh.a., SIGMA sh.a., SIGAL sh.a., ATLANTIK sh.a., INTERSIG sh.a., ALBSIG sh.a. dhe SIGAL LIFE sh.a., sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të konsiderojë të mjaftueshme provigjionet teknike të datës 31.12.2005 të përlllogaritura nga sektori i aktuaristikës së Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për shoqëritë INTERALBANIAN, sh.a., DUKAGJINI AL sh.a., dhe SICRED sh.a., sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shoqëritë e sigurimit INTERALBANIAN sh.a., DUKAGJINI AL sh.a., dhe SICRED sh.a., të zbatojnë provigjionet teknike të përlllogaritura nga sektori i aktuaristikës të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Shoqëritë e sigurimit të pasqyrojnë provigjionet teknike dhe matematike në pasqyrat financiare në formën bruto me risigurimet, si dhe pjesën e risiguresit në provigjionet teknike sipas kërkesave të udhëzimit nr.1, datë 22.12.2004 të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

5. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe e inspektimit për të verifikuar aktivet dhe drejtimet e investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera

ANEKS

PROVIGJONET TEKNIKE E MATEMATIKE (NETO NGA RISIGURIMET) MË 31.12.2005 PËR
SHOQËRITË E SIGURIMIT

INSIG JOJETË	1.692.336.344 lekë
INSIG JETË	69.256.435 lekë
SIGMA	730.295.009 lekë
SIGAL	998.941.990 lekë
ATLANTIK	249.783.140 lekë
INTERSIG	150.382.604 lekë
INTERALBANIAN	90.277.817 lekë
DUKAGJINI AL	25.983.473 lekë
ALBSIG	91.880.785 lekë
SICRED	29.213.303 lekë

SIGAL LIFE	39.265.885 lekë
------------	-----------------

PJESA E RISIGURUESIT NË PROVIGJONET TEKNIKE E MATEMATIKE MË 31.12.2005

INSIG JOJETË	599.115.350 lekë
INSIG JETË	7.384.058 lekë
SIGMA	50.870.700 lekë
SIGAL	81.525.403 lekë
ATLANTIK	
INTERSIG	
INTERALBANIAN	3.399.789 lekë
DUKAGJINI AL	
ALBSIG	
SICRED	7.166.556 lekë
SIGAL LIFE	